



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 38

Prishtinë, më 22.03.2016, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivkoviç, Agim Çeku, Mufera Shinik, Agim Kikaj, Milka Vuletiq, Sasha Milosavleviç, Slavko Simiq, Qerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi.

Munguan: Fisnik Ismaili dhe Rustem Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje: përfaqësuese e OSBE-së, Dhurata Kryeziu; përfaqësuese e KDI-së, Mërgime Kajtazi; gazetar e programit TV – Rrokum, Dredhëza Ahmetxhekaj; gazetar e programit Kosova Press, Gentiana Kadrija; konsultanti i Sekretariatit të KKK, Zijush Ahmeti dhe Celal Iliaz, Drejtoria për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Jasmina Zhivkoviç**, kryesuese e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportimi i drejtorit të Zyrës për Komunitete lidhur me implementimin e strategjive të Qeverisë, që kanë të bëjnë me komunitetet.**

I ftuar: drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve pranë Zyrës së Kryeministrit, Ivan Tomiq.

- 1. Miratimi i rendit të ditës:**

Kryesuesja konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

- 2. Raportimi i drejtorit të Zyrës për Komunitete lidhur me implementimin e strategjive të Qeverisë, që kanë të bëjnë me komunitetet**

Kryesuesja theksoi se për takimin e sotëm, Komisioni ka ftuar Ivan Tomiq, drejtor i Zyrës për Komunitete, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe mospjesëmarrja e tij karakterizohet me

papërgjegjësi të plotë. Në kuadër të procedurave, është dashur, paraprakisht ta njoftojë Komisionin, për arsyen e mospjesëmarrjes në takim.

Danush Ademi, mosprezenca e drejtorit Ivan Tomiq, paraqet neglizhencë në ngritjen e çështjeve për pjesëtarët e komuniteteve. Si pyetje e tij e veçantë ishte që i njëjti të njoftojë Komisionin, sa ka njohuri për kodin e veçantë për komunitete, të cilin e kemi votuar me rastin e miratimit të buxhetit. Kjo çështje ka peshë të madhe për qytetarët e komunitetit pakicë. Ishte i mendimit që Komisioni të përsërisë ftesën, në emër të drejtorit të Drejtorisë për Komunitete dhe njëherazi të ftohet njëri nga zëvendëskryeministrat e Qeverisë, që të ofrojnë sqarime lidhur me implementimin e kodit të veçantë për komunitete.

Veton Berisha, nuk e arsyeton mosprezencën e drejtorit për Çështje të Komuniteteve, ngase i njëjti ka obligim të ofrojë fakte për mungesën e tij në takim. Ajo çka e shqetëson më së shumti është se Zyra për të Drejtat e Komuniteteve, në kuadër të Kryeministrit, ende nuk ka zgjedhur zëvendësdrejtorin, ku i takon përfaqësimi nga radha e komuniteteve tjera.

Çështjet të cilat duhet shtjelluar, janë të natyrave të ndryshme, si p.sh. çfarë planesh ka Drejtoria për Komunitete, përfaqësimi i komuniteteve në institucionet publike. Si vërejtje tjetër është se kjo zyrë nuk ka koordinim me Kabinetin e Kryeministrit.

Në kuadër të vërejtjeve të tija, dha propozim që përsëri të ftohet drejtori i Zyrës për Komunitete, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.

Sasha Milosavljević, gjithashtu, shprehu pakënaqësinë e tij për neglizhencë të drejtorit Ivan Tomiq, ku përkundër angazhimeve të tij, do të ishte e arsyeshme të caktojë një përfaqësues të Zyrës për Komunitete, që të marrë pjesë në mbledhje të Komisionit.

Sipas mendimit të tij, kjo çështje nuk duhet heshtur, por të procedohet ftesa në afat sa më të afërt, me qëllim që i njëjti të raportojë lidhur me Strategjinë e Qeverisë, si dhe bashkëpunimi i Zyrës për Komunitete, në kuadër të Qeverisë, në raport me Zyrën e Kryeministrit.

Qerim Bajrami, nuk është hera e parë që ministrat nuk janë i përgjigjur ftesës sonë, në këtë rast drejtori i Zyrës për Komunitete, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Mospërfillja e ftesës është për kritikë, ngase i njëjti ka mundur të gjejë formë, që të njoftojë kryetaren apo administratën për mbështetje të Komisionit.

Sipas diskutimit të parafolësit, Danush Ademi, mendon se duhet të jemi më të saktë, ngase nuk është miratuar këtë vit kodi për ndarjen e mjeteve për komunitetet. Ai dha sqarime se është miratuar amendamenti i Komisionit për Buxhet dhe diskutoi lidhur me propozimin e paragrafit: “Qeveria e Kosovës, në bazë të përgatitjeve paraprake, gjegjësisht Ministria për Komunitete dhe Kthim, të nxjerrë vendim për ndarje buxhetore për komunitete, ndërsa deri më sot nuk kemi informata në nxjerrjen e vendimit në fjalë.

Njëra nga temat kryesore për diskutim me drejtorin e Zyrës për Komunitete, është se si e parasheh kjo zyrë ndarjen e mjeteve buxhetore për komunitetet.

Ai shtoi se kemi pasur vërejtje vitin e kaluar, me rastin e miratimit të rebalancit për buxhet, të vitit 2015, ndërsa shpreson se e njëjta gjë nuk do të përsëritet edhe këtë vit.

Kryesuesja pajtohet me parafolësit se Komisioni do t’u përmbahet detyrave të përcaktuara të planit të punës, që periodikisht të ftohen ministrat e linjës. Përkundër faktit që në këtë takim mungon drejtori, Komisioni do të përsërisë ftesën, në emër të Ivan Tomiq, për javën e ardhshme.

Pas diskutimeve, kryesuesja udhëzoi administratën e Komisionit, që sa më parë ta kontaktojnë Ivan Tomiq, për kohën kur mund t’i përgjigjet ftesës së Komisionit, me qëllim që të raportojë për zhvillimet e Strategjisë së Qeverisë, në kuadër të komuniteteve.

3. Të ndryshme

Për realizimin e vizitës studimore në Kuvendin e Republikës së Kroacisë, ka mbetur e papërcaktuar mënyra e udhëtimit. Theksoi se OSBE-ja financon të gjitha shpenzimet e udhëtimit për 8 anëtarë të Komisionit, ndërsa për anëtarët tjerë dhe administratën do të financohen nga buxheti vjetor i Komisionit.

Pas konsultimeve lidhur me udhëtimin në Kuvendin e Republikës së Kroacisë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, nxori këtë

Përfundim

Në kuadër të marrëveshjes dhe përkrahjes së OSBE-së, anëtarët e Komisionit pajtohen që vizita të realizohet, në muajin maj 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Jasmina Zhivković